



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA  
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

KOSOVO CENTER FOR PUBLIC SAFETY EDUCATION AND DEVELOPMENT  
QENDRA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE EDUKIM DHE ZHVILLIM  
KOSOVSKI CENTAR ZA JAVNU BEZBEDNOST OBRAZOVANJE I RAZVOJ

**Duke u bazuar në rregulloren 2001/36, Urdhëresën administrative 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/1, Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtri, zyra Personelit shpallë:**

**K O N K U R S**

**Titulli i Vendit të punës: Shef i Sektorit të Armëve të Zjarrit**  
**Raporton: Drejtori i Departamentit të Përkrahjes Programore**  
**Koeficienti:(8) Sipas Rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil**  
**Nr.Ref: 23/2010**  
**Vendi: Vushtri**

**Përgjegjësitë:**

- Mbikëqyrë, kontrollon dhe mirëmban përgjegjësitë ndaj sektorit të armëve të zjarrit, për të gjitha instruktorët e armëve të zjarrit, raporton, çka përfshinë por nuk kufizohet në interiorin e ndërtesës, eksterierin, poligonin e mbyllur të gjuajtjes me armë zjarri, mësimin në klasa, depotë dhe të gjitha poligonat e gjuajtjes.
- Të mirëmbaj armët siq nevojiten për shkak të mosfunksionimit të armëve dhe të mbajë evidencën e riparimeve. Të zhvilloj dhe dizajnoj materiale të reja për trajnime dhe mbikëqyrë trajnimet e të gjithë studentëve të sigurohet se zhvillohen trajnime profesionale sipas standardeve më të mira.
- Raporton drejtpërdrejtë tek Drejtori i Mbështetjes Programore.

**Përshkrimi i punës:**

- Kontrollon, mirëmbanë dhe Programon kurset për Simulator të Armëve të Zjarrit.
- Përgjegjës për vendosjet e procedurave, shkruarjen e PSO zhvillimin e formave dhe mbajtjen e të dhënave të mirëmbajtjes dhe pronës.

- Përgjegjës për inventarin e armëve, pajisjeve dhe shpenzimeve.
- Është përgjegjës për sigurinë e armëve dhe municionit, regjistrimin e armëve, dhënien dhe pranimin e armëve dhe municionit si dhe mbajtjen adekuatë të furnizimit ekzistues dhe furnizimin e rri me municion.
- Inspekton, pastron dhe identifikon dëmtimet dhe riparimet që duhet të kryhen.
- Pranon pronën dhe evidenton nga zyrtarët e zbatimit të ligjit, dokumenton pjesët mban zingjirin teknik të posedimit nga hyrje gjer tek gatishmëria finale dhe siguron integritetin e procesit të menagjimit të evidencës.
- Mbledh, rruan, regjistron dhe siguron evidencat nga zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe zyrtarët doganor në pajtueshmëri me ligjet e Kosovës, rregulloret e agjensioneve dhe procedurat, krijon dhe ruan të gjitha evidencat në mënyrë të renditur mban regjistrin e aktiviteteve dhe krijon raporte sipas nevojës.
- Deponon, siguron pronën dhe evidenton duke përfshirë edhe ato të konfiskuarat, të kthyerat dhe të gjeturat, bën futjen e të dhënave të reja në kompjuter liron/dorzon/sendin/ tek pala e autorizuar dhe dokumenton kthimin e evidencave tek kujdestari/mbajtësi.
- Siguron dhe ruan të gjitha evidencat për mirëmbajtjen e zingjirit të rregullt të evidencave.
- Mban librin e regjistrimit të pronës së dhomës dhe regjistrin e inventarit verifikon kompletimin e raporteve dhe dokumentacionin e rasteve dhe mbanë regjistrin e rregullt të pronës.
- Lëshon, ruan dhe mirëmbanë paisjet e agjensioneve, armët, municionin dhe furnizon si udhëzohet.
- Përmbush edhe detyra tjera siq përcaktohet dhe kërkohet.
- Trajnon studentët dhe stafin e sektorit të armeve të zjarrit për të siguruar zhvillimin e stafit.

#### **Njohuritë dhe Aftësitë:**

- Njohuri të rregullave për mbledhjen, ruajtjen dhe sigurimin e evidencave.
- Njohuri të mbajtjes së shënimeve dhe menagjimit të të dhënave.
- Aftësi pune me kompjuter për të dhëna (shënime).
- Aftësi në komunikim efektiv të shkruar dhe verbal.
- Administimin e inventarit të armëve dhe municionin.

#### **Kualifikimi Minimal:**

- I Çertifikuar për Simulator të Armëve të Zjarrit.
- Aftësi për të punuar nën presion.
- Minimum certifikimi nga kursi “ **Armëtar i GLOCK-ut** ”.
- Aftësi të hartoj raporte koncize dhe logjike si dhe mbaj shënime të rregullta.
- Të ketë së paku 6 vite eksperiencë si armëtar për armë të ndryshme.
- Aftësi të mira me kompjuter.
- Aftësi të funksionalizoj armën dhe mirëmbajtjen e tyre.

**Paraqitja e kërkesave:**

Formularët e kërkesave mund të merën dhe të dorëzohen në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim respektivisht zyrën e personelit nr.101,adresa Rr.Skenderbeu pn.Vushtrri.Data e mbylljes së kërkesave 15 ditë pas shpalljes në ndonjë nga gazetata zyrtare të Kosovës.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim nuk do të merën parasysh ndërsa kërkesat e pakompletuara dhe ata te cilët nuk i kane kualifikimet adekuate nuk do të merën parasysh dhe nuk do të shqyrtohen dhe pranohen.

Tel kontaktues 028/70-008 lok 114 në rast të ndonjë paqartësie dhe këshille.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të ftohen për intervistim.

**Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës,dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve në Kosovë.**